

## AKT THEMELIMI

### I

### SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“Lani-akea” SH.P.K

Ortaku i vetëm i Shoqërisë, Erni Kocani, me atësi Dhimiter dhe amësi Ilda, d.t. 01.10.1987, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, Sheshi “Jozef San Martin”, ndërtesa 1, shkalla 9, Tiranë me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar,

bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjin Nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, mbledhur në Tiranë sot më datë

07.11.2022

#### VENDOSI:

Të krijojë një shoqëri tregtare dhe për këtë qëllim të hartojë dhe miratojë këtë Akt Themelimi të shoqërisë si më poshtë vijon;

#### NENI 1 *Emri*

1.1 Shoqëria do të paraqitet në qarkullimin tregtar me emërtimin e saj "Lani-akea" sh.p.k.

1.2 Ndryshimi i emrit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqerise (Ortaku i vetem).

#### NENI 2 *Forma juridike*

2.1 Shoqëria tregtare “Lani-akea” sh.p.k, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k).

2.2 Shoqëria mund të transformohet në një formë tjetër juridike me vendim të Asamblesë së Përgjithshme (Ortaku i Vetem) sipas përcaktimeve në ligj dhe në Statutin e saj.

#### NENI 3 *Selia*

3.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën, Rruga “Abdyl Frashëri”, pallati 2, shkalla 1, njësia bashkiakë nr. 5, 1017, Tiranë.

3.2 Ndryshimi i selisë së shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë (Ortaku i Vetem).

**3.3 Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë (Ortaku i Vetëm) shoqëria mund të hapë degë të saj apo Zyra përfaqësimi në qytete të tjera apo dhe jashtë Shqipërisë.**

**NENI 4**  
*Vula e shoqërisë*

**4.1 Shoqëria do të ketë vulën e saj.**

**4.2 Forma e vulës dhe masa e saj do të përcaktohen nga Asambleja e Ortakëve (Ortaku i vetëm) në përputhje me legjislacionin shqiptar.**

**NENI 5**  
**Objekti i Veprimtarisë**

**5.1 Shoqëria ka si objekt veprimtaritë që vijojnë më poshtë:**

Shërbime konsulence, ofrimi i shërbimeve përmes një strukture informatike dhe telekomunikacionit, dhënie të shërbimeve të konsulencës në lidhje me shërbimet statistikore duke përfshirë edhe përpunimin e të dhënave të shoqërive të tjera, shërbime këshillimi dhe mbështetje në fushën e organizimit. Kryerja e hulumtimeve të marketingut, marrja e informacionit nga tregu, analizimi i të dhënave dhe zhvillimi i strategjive të ndryshme të marketingut. Shoqëria mund të kryejë cdo veprimtari të lidhur dhe të ngjashme me ato të renditura më sipër në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi

**5.2 Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë çfarëdolloj veprimtarie tjetër të lejuar nga ligji dhe në përputhje me rregullat në fuqi.**

**NENI 6**  
**Kohëzgjatja e Shoqërisë**

**6.1 Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje me një afat të pacaktuar.**

**6.2 Shoqëria ka personalitet juridik duke filluar nga momenti i regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.**

**NENI 7**  
**Kapitali i Shoqërisë dhe Kuotat**

**7.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë është i përbërë nga kontributi në para i Ortakut të vetëm në vlerën 100.000 lekë.**

Ortaku i Vetëm i Shoqërisë, zotëron një kuotë me vlerë 100.000 lekë (njëqind mijë lekë), e cila përbën 100 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

**7.2 Kontributet që përbëjnë 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë janë shlyer tërësisht nga Ortaku i Vetëm.**

**7.3 Financimet në formë huaje të bëra nga ortaku do të konsiderohen si hua pa interes.**



**NENI 8**  
*Organet e Shoqërisë*

**8.1 Organet drejtuese të shoqërisë janë:**

- Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i vetem).
- Administratori

**8.2 Kompetencat, të drejtat dhe detyrat e këtyre organeve do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.**

**NENI 9**  
*Të drejtat dhe detyrimet e Ortakut të Vetëm*

**9.1** Ortaku jep kontributin e tij në shoqëri në para apo në natyrë, sipas mënyrave dhe afateve të përcaktuara në statut, në të cilën është përcaktuar në mënyrë të detajuar kontributi dhe mënyra e afatit e derdhjes së këtij kontributi në këtë shoqëri. Ortaku i Vetëm përgjigjet ndaj shoqërisë personalisht dhe në mënyrë solidare për dëmet e shkaktuara nga mospërbushja e këtyre detyrimeve apo nga përbushja e tyre përtej afateve përkatëse. Ortaku i Vetëm mban përgjegjësi për humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

**9.2** Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë informojnë ortakun për securinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare dhe, me kërkesën e tij, duhet t'i vënë në dispozicion llogaritë vjetore, përfshirë llogaritë e konsoliduara, raportet për gjendjen dhe securinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare, raportet e organeve drejtuese apo të ekspertëve kontabël të autorizuar, si dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të shoqërisë.

**9.3** Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë informojnë Ortakun e Vetëm për periudha njëmuore dhe tremujore për securinë e shoqërisë, realizimin e objektivave mujore dhe tremujore, llogaritë, raportet për gjendjen dhe securinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare me partnerët nënkontraktorë, raportet e organeve drejtuese apo të ekspertëve kontabël të autorizuar, si dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të shoqërisë.

**9.4** Ortaku i Vetëm i Shoqërisë ka të drejtë të heqi dorë nga Shoqëria dhe mund të shesi kuotën nëpërmjet nënshkrimit të kontratës së shitjes se kuotës, pa qenë nevoja e marrjes së një vendimi paraprak nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë në përputhje me kushtet që i lejon Statutit dhe Ligji. Heqja dorë nga shoqëria nuk e liron atë nga detyrimet që ka deri në momentin e heqjes dorë dhe nuk e cënon atë në marrjen e të ardhurave që Shoqëria ka siguruar deri në këtë moment.

**9.5** Gjatë ushtrimit të të drejtave, Ortaku i Vetëm vepron duke marrë parasysh interesat e shoqërisë. Ortaku i Vetëm respekton detyrimet që burojnë nga Akti i Themelimit dhe Statuti. Ai përpinqet për zhvillimin e aktivitetit të Shoqërisë sipas objektit të veprimtarisë së saj.

**NENI 10**  
*Administratori*

**10.1** Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i vetem). Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.



**10.2** Administrator i Shoqërisë është Z. Erni Kocani, me atësi Dhimiter dhe amësi Ilda, d.tl. 01.10.1987, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, Sheshi "Jozef San Martini", ndërtesa 1, shkalla 9, Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me ID nr. 034919867 dhe nr. personal I71001073D.

**10.3** Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i vetëm) mund të emërojë një administrator të dytë me vendim të saj.


**NENI 11**  
*Dispozita të fundit*

**11.1** Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me Aktin e Themelimit, Statutin dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi. Për sa nuk parashikohet në Aktin e Themelimit dhe në Statut, do të zbatohen kryesisht dispozitat e ligjit «Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare», Kodit Civil dhe legjislacionit në fuqi.

**NENI 12**

**12.1** Ky Akt themelimi përpilohet në 5 (pesë) kopje në gjuhën shqipe, dhe u nënshkrua pa vërejtje nga ortaku themelues.

**ORTAKU THEMELUES  
ERNI KOCANI**

  
Erni Kocani